

DEMOSOT



NE SI QYTETARË TË DEMOKRACISË

ENIS (11), ORGEST (10), ELDA (10), ELDISON (10), ELVIS (10)

Ne sot do të flasim për mënyrën se si funksionon demokracia dhe cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë tona si qytetarë të Kosovës

Ne dijmë se demokracia rrjedh nga gjuha greke ku „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që i bie qeverisje.

Demokracia ndahet në dy lloje, në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe demokracinë përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme, të cilat janë: sistemi presidencial dhe sistemi parlamentar. Në sistemin presidencial, Presidenti udhëheq shtetin e vet, kurse në sistemin parlamentar shteti udhëhiqet nga Kuvendi, i cili zgjedh pastaj Qeverinë. Ne mendojmë se Kosova në të ardhmen e saj, do të ketë më shumë demokraci për të dy gjinitë. Në demokraci ne i kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona. E kemi të drejtën për jetesë, kurse përgjegjësi kemi ta respektojmë gjithmonë ligjin.




Grupi „Dredhëza“, qytetarë të Kosovës



Këtu kemi paraqitur se si ne qytetarët duhet të veprojmë



Këtu kemi shkruar parimet e demokracisë



Llojet e demokracisë



Ne punojmë së bashku

TË FLASIM PËR KUVENDIN

KLEVIS (10), OLTİ (10), LAURETA (10), ASDREN (10)



Lexoni më poshtë se çfarë veçantie ka Kuvendi i Kosovës për ne, nxënësit e klasës V-1

Ne filluam diskutimin për demokracinë, barazinë, lirinë dhe tolerancën që duhet të kemi dhe të praktikojmë çdo ditë. Vetëm me arsimim mundemi të arrijmë



qëllimet tona të mira, por për t'i arritur qëllimet na duhet edhe toleranca dhe liria.

Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë dhe 100 prej tyre janë shumicë, kurse 20 prej tyre i takojnë komuniteteve jo shumicë. Deputetët pyesin Qeverinë nëse ajo nuk e menaxhonë mirë shtetin. Deputetët duhet t'i dijnë problemet shtetërore dhe duhet të mundohen t'i zgjidhin ato. Përfaqësuesit ndryshe quhen deputetë. Kuvendi mbikëqyr Qeverinë dhe deputetët që punojnë në Kuvend miratojnë ligjet. Pasi një qytetar i kalon 18

vjet , ai ka të drejtë të votoj apo të kandidoj për deputet. Kur një qytetar voton ai duhet që fletën e votimit ta fus në një kuti, e cila është e mbyllur dhe prej së cilës merren fletat e votave. Një njëri mund të kandidoj për deputet vetëm për Kuvendin e shtetit ku është qytetar i regjistruar dhe p.sh nuk mund që të kandidoj në shtetet e Amerikës. Ligjet janë rregulla dhe ato na ndihmojnë që ta përmirësojmë shtetin tonë, kurse ne duhet t'i respektojmë ato. Duke i respektuar ligjet, ne mësojmë se çfarë duhet të bëjmë e të mos bëjmë. Në qoftë se kemi problem në shkollë apo në ndonjë vend tjetër, atëherë përfaqësuesit e popullit e diskutojnë atë problem për ne.

Çdo qytetar i popullit në një shtet demokratik është i barabartë, edhe pse dikush është më i vogël, e dikush më i madh.



Autorët e artikullit

ZGJEDHJET NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

ENES (10), LEON (10), YLLI (10), ANDI (10), FJOLLA (9)

Procesi i marrjes së pushtetit në mënyrë demokratike

Zgjedhjet janë një proces i rëndësishëm i vendit tonë. Me anë të zgjedhjeve, ne i zgjedhim përfaqësuesit e popullit. Të drejtë vote kemi në moshën 18 vjeçare, sepse në këtë moshë jemi më të pjekur dhe e dijmë më mirë se kë duhet ta votojmë.

Në Republikën e Kosovës janë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet parlamentare, ku zgjedhen deputetët dhe zgjedhjet komunale, ku zgjedhet kryetari i çdo komune dhe asambleistët. Përfaqësuesit të cilët i zgjedh populli duhet të jenë të drejtë, të mençur, tolerantë dhe duhet t'i trajtojnë të gjithë në mënyrë të barabartë pa dallim race, gjinie dhe feje. Vota e secilit prej nesh mund të bëjë ndryshim, prandaj është shumë e rëndësishme pjesëmarrja në zgjedhjet e vendit.



Gazetarët e „Demos-ti“



Ne mësuam për procesin zgjedhor



Zgjedhjet janë proces i rëndësishëm



Të gjithë jemi të barabartë



Një votë e jona mund të bëjë ndryshim

NDARJA E PUSHTETIT NË DEMOKRACI

JONI (13), EDI (10), HANA (10), VLERA (10), ESMA (9)


Ne dëshirojmë t'iu flasim për ndarjen e pushtetit në demokraci. Ne jemi nxënësit e klasës V-1 të shkollës „Faik Konica“, dhe sot jemi gazetarët e demokracisë

Demokracia e ka kuptimin nga fjalët greke „demos“ dhe „kratia“, që do të thotë se ajo është udhëheqje e popullit. Forma e parë e demokracisë ka qenë demokracia direkte ku njerëzit flisnin drejtpërdrejtë për mendimet e tyre.

Forma e dytë e demokracisë ka qenë demokracia përfaqësuese, ku populli ka votuar për një përfaqësues i cili do të përfaqësoj popullin e tij. Kjo formë ekziston edhe sot.

Tani do t'iu flasim për Kuvendin. Në Kosovë institucionin kryesor legjislativ e kemi Kuvendin. Detyra e Kuvendit është që t'i shkruaj ligjet në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Në Kushtetutë ka shumë ligje të cilat duhen të respektohen nga të gjithë ne, qytetarët

e Kosovës. Ligjet nga Kuvendi shkojnë në Qeveri, dhe aty zbatohen. Në Qeveri punojnë Kryeministri, ministrat dhe zv. ministrat. Qeveria është institucion ekzekutiv. Kuvendi ka për detyrë të kontrolloj Qeverinë, duke iu bërë pyetje ministrave nëse ata po i zbatojnë ligjet siç duhet. Pushteti gjyqësor përbëhet nga gjykatat, të cilat i gjykojnë qytetarët nëse ata kanë shkelur ligjin. Në gjykatë punojnë gjykatësit, avokatët, prokurorët, etj. Gjykata duhet të punoj e pavarur nga institucionet e tjera. Pushteti duhet të ndahet, sepse atëherë ka ndarje të punëve dhe përgjegjësisë, ashtu siç ne i ndajmë punët dhe përgjegjësitë në shtëpi, në shkollë, dhe kudo. Duke u ndarë punët, ne tregojmë mirëkuptim ndaj njëri tjetrit.



Shkrimet tona për ndarjen e pushtetit




Ne, gazetarët e gëzuar duke mësuar për ndarjen e pushtetit

Nxënësit e klasës V-1



Sa e mirë është demokracia...

Duke i shprehur mendimet tona për demokracinë



Punimi ynë për institucionet e demokracisë



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Faik Konica“
Klasa: V-1
Vendi: Prishtinë